

Dalës-izlezes

Nr. -1-140  
Br.

Data 30.10.2023  
Datum

OBILIC-OBILIC



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E OBILIQIT**  
**OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OF OBILIC**

**KUVENDI KOMUNAL OBILIQ**

Skupština Opštine Obilic - Municipality Assembly of Obiliq

Në mbështetje të nenit 11, 12 të paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), neni 17 paragrafi 1, shkronja g) dhe neni 40 paragrafi 1 dhe 2 shkronja l) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neni 12 paragrafi 1.6 dhe neni 31 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 bazuar i Rregullores (QKRK) Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të Tjera, ndërlidhur me nenin 90 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të Tjera, dhe neni 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës nr.-I-34, të dt.25.04.2016, si dhe neni 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi Komunal pas shqyrtimit të Propozimit nr.-II-1466, të dt.20.10.2023, të Kryetarit të Komunës, në mbledhjen e mbajtur me dt.30.10.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

(Për miratimin e Raportit përfundimtar nr.-XVI-136, të dt.19.10.2023, hartuar nga Komisioni Komunal i caktuar nga Kryetari i Komunës me Vendimin nr.-II-1174, të dt.28.08.2023, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga shiu (vërshimet) dhe breshëri në muajin prill, qershor dhe korrik të vitit 2023 në vlerë totale prej 159,868.93 euro).

**Neni 1**

Miratohet Propozimi me nr.-II-1466, i dt. 20.10.2023, për Miratimin e Raportit Përfundimtar nr.-XVI-136, të dt.19.10.2023, hartuar nga Komisioni Komunal i caktuar nga Kryetari i Komunës me Vendimin nr.-II-1174, të dt.28.08.2023, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga shiu (vërshimet) dhe breshëri në muajin prill, qershor dhe korrik të vitit 2023. Dëmet iu janë shkaktuar 61 fermerëve, në kultura bujqësore nga shiu (vërshimet) dhe 3 fermerëve në kultura bujqësore nga breshëri ku gjithsejt janë konstatuar 64 fermerë që iu kanë shkaktuar dëmet në territorin e Komunës së Obiliqit, në vlerën prej 159,868.93 euro.

**Neni 2**

Për miratimin e këtij vendimi miratohet Raporti i Dëmeve i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, i shqyrtuar nga Kryetari i Komunës, që përmban një vlerësim profesional nga të dhënat e evidentuara dhe të regjistruara nga dalja në vendshikim të Komisionit paraprak të emëruar nga Kryetari i

Komunës dhe kërkesave për kompensim të dëmeve nga qytetarët (familjet) e dëmtuara nga vërshimet dhe breshëri të cekura në pikën 1 dhe i njëjti raport i miratuar në Kuvendin Komunal në afat prej 15 ditëve nga dita e miratimit i dorëzohet Agjencisë së Menaxhimit Emergjent dhe një kopje të njejtësuar Komisionit Qëndror të themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

### Neni 3

Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Komisionin Profesional Komunal mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e reshjeve të shiut.

### Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të MAPL- dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

**Bashkëngjitur:** Raporti nr.-XVI-136, të dt.19.10.2023, dhe vendimi i Komisionit Komunal nr.-II-1174, i dt.28.08.2023,

T'i dërgohet

- Kryetarit
- AME -së
- Komisionit Qendror Qeveritar
- MAPL-se
- Arkivit



Anëtari më i vjetëri Kuvendit Komunal

Enver Gashi